



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit/Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Drejtoria për Financë dhe Buxhet

Uprava za Finansije i Budzet

Department of Finance Budget



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odelenje za Opštu Upravu
-III- Nr. i prot. 180 Br. prot. Dt. 20.11.2020
RAHOVEC - ORAHOVAC

Raporti i punës së Drejtorisë për Buxhet dhe Financa për vitin 2019

Ky raport përfshinë të dhënat për periudhën Janar- Dhjetor 2019 nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa, konkretisht nga sektori për Buxhet&Financave, dhe Sektori i Tatimit në Pronë. Numri i punëtoreve: 13.

❖ Sektori i Buxhetit dhe Financave

Bazuar në obligimet ligjore të cilat dalin nga Ligji mbi Financat Publike dhe përgjegjësitë, Ligji i financave të pushtetit Lokal, Statutit të Komunes, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, konsiderojmë që i kemi kryerme përgjegjësi të gjitha detyrat dhe obligimet që na takojnë.

Në drejtorinë për Buxhet dhe Financa, kemi arritur që detyrat dhe obligimet që dalin para kësaj drejtorie të kryhen në afate ligjore duke evidentuar dhe regjistruar të gjitha të hyrat sipas kategorive të tyre, si dhe shpenzimin e Buxhetit të gjitha kategorive, ku përqindja e shpenzimit të buxhetit deri në këtë datë është.

Ndonëse Buxheti nuk është aprovuar me kohë me 30 shtator nga ana e asamblese komunale, mirpo miratimin e buxhetit e presim me u aprovu në Janar të vitit 2020.

Gjate kësaj periudhe të punës kemi mbajtur disa takime: ndëgjime buxhetore me qytetarë në të gjitha vendbanimet e Komunës Rahovecit me komuniteti për politik dhe financa, dhe nga ekzekutivi i komunës. Gjithashtu kemi mbajtur trajnime të ndryshme me MF, organizata të ndryshme, apo donator që kryesisht janë trajtuar qeshjet financiare.

Tek shpenzimet Operative kemi arritur të kursejmë disa shpenzime kryesisht Mallra dhe shërbime në pa e dëmtuar buxhetin në kategori të tjera, duke i rritur disa shpenzime-shërbime të cilat në të kaluarën janë paguar nga kapitalet e realisht kanë qenë Mallra Shërbime, siç janë mirëmbajtja e ndërtesave dhe rrugëve, pastrimi i rrugëve, rrënimi i objekteve pa leje, sinjalizimi i rrugëve etj, gjithashtu kemi arritur që të kemi një inkasim të mirë të të hyrave vetanake duke i tejkaluar të hyrat e planifikuara për vitin 2019.

Në Drejtorin për Buxhet dhe Financa, janë realizuar detyrat kryesore duke respektuar edhe afate ligjore të rregulluara më ligjet që rregullojnë financat publike.

Sipas muajve për gjatë vitit 2019 kemi realizuar këto detyra:

- Përgatitja e Rrjedhes së Parase për buxhetin e vitit 2019 - (Janar 2019),
- Përgatitja e raportit financiar për mbylljen e vitit fiskal 2018 për Kuvendin komunal dhe Ministrin e Financave dhe Zyres Kombëtare të Auditimit - (Janar - mars 2019),
- Raport për obligimet e bartura nga viti 2018, për obligimet financiare dhe ato kontraktuale,
- Raport, (informatë) për shpenzimet dhe të hyrat për çdo tremujor gjatë vitit 2019,
- Zbatimi i rekomandimeve të Auditoreve.
- Ndegjimet buxhetore me qytetarë-Qershor – Korrik 2019
- Përgatitjet për buxhetin e vitit 2020, qarkorja e parë, KAB-it - qarkorja e dytë, (Maj-Gusht 2019),
- Mungese Rishikimi i buxheti për vitin 2019 në Kuvend
- Përmbushja dhe tejkalimi i planit të hyrave Komunale(vetanake).
- Shpënzimi sa më i madh i buxhetit në përqindje

Komuna e Rahovecit për **vitin 2019** ka operuar me një buxhet prej: **13,760,891.00 euro** të përberë nga Grandi qeveritar dhe të hyrat vetanake:

-Grandi i qeveritar	12,423,508.00 euro,
-Të hyrat vetanake	1,168,758.00 euro,
-Huamarrja	168,615.00 euro,
-Gjithsej:	13,760,891.00 euro.

Shpërndarja e buxhetit nëpër kategori ekonomike në vitin 2019 ka qenë:

-Paga e mëditje	7,537,669.00 euro,
-Mallra dhe shërbime	1,514,330.00 euro,

-Shpenzime komunal 255,500.00 euro,
 -Subvencione 250,001.00 euro.
 -Investime kapitale 4,203,391.00 euro,

Të hyrat e bartura nga viti 2018 në vitin 2019 kanë qenë: 402,564.38 euro.

❖ Shpenzimi i buxhetit në vitin 2019

Shpenzimi i buxheti Janar-Dhjetor 2019						
Nr.	Përshkrimi	Lëndët te certifikuara	Buxheti i aprovuar 2019	Buxheti alokuar	Shpenzimet	Shpenzimi i buxheti të planifikuar %
1	Paga dhe mëditje	0	7,537,669.00	7,352,332.30	7,330,406.30	96.97
2	Mallra dhe Shërbime	2459	1,514,330.00	1,363,464.28	1,348,172.18	94.84
3	Shërbime Komunale	670	255,500.00	255,500.00	246,469.32	96.47
4	Subvencione	285	250,001.00	1,240,001.00	1,216,728.26	97.34
5	Investime Kapitale	304	4,203,391.00	4,668,689.30	4,542,925.76	97.31
	Totali	3,718	13,760,891.00	14,879,986.88	14,684,701.82	96.90

❖ Të hyrat vetanake

➤ Tatimi në prone

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2019 sektori i tatimit në pronë ka realizuar të hyra prej 445,852.48 euro të planifikimit vjetor (planifikimi vjetor 388,767.00) euro. Regjistrimet e reja janë 462 objekte , ose 76.283.00 m². Verifikimi i objekteve është 2670,ose 416.517 m².

Të hyrat në përgjithësi:

Të hyrat e përgjithshme vetanake të realizuara për këtë periudhë janë 1.277,166.86 euro, pra 108,398.86 tejkallim i planit vjetor të planifikimit vjetor (planifikimi vjetor 1,168,758.00).

❖ **Përgatitja e buxheti për vitin 2020**

Me 15.05.2019 kemi pranuar Qarkoren Buxhetore 2020/1 dhe me date 08.08.2019 Qarkoren Buxhetore 2020/02 nga Ministria e Financave e cila paraqet bazën për hartimin e Buxhetit për vitin 2020 dhe vlerësimet për vitet 2021 dhe 2022. Me këtë qarkore buxhetore janë ndarë kufijtë fillestar buxhetor për vitin 2020, ku Komunës së Rahovecit sipas kësaj Qarkoreje ju ka ndarë një buxhet prej **14,735,819.00€**.

Kemi përgatitur dhe kemi dërguar në Kuvend **Kornizën Afatmesme Buxhetore - KAB** për vitet 2020-2022

Projeksionet e shpenzimeve buxhetore për vitin 2020 do të paraqesim sipas kategorive ekonomike:

- Pagat dhe mëditje..... 8,644,220.50€;
- Mallrat dhe Shërbim..... 1,594,330.00 €;
- Shpenzimet Komunale..... 280,500.00€;
- Subvencionet dhe Transferet..... 311,000.00€;
- Shpenzimet Kapitale.....3,905,769.50€

TOTAL.....14,735,819.00€

Sfidat për vitin 2020:

- ✓ **Realizimi (inkasimi) sa më i madh i të hyrave vetanake gjatë vitit 2020,**
- ✓ **Rritja e përgjegjësisë dhe kontrollit të menaxhimit të financave për vitin 2020,**
- ✓ **Zbatimi i terësishëm i rekomandimeve të auditorit Kombëtar, dhe atij të mbrendshëm**
- ✓ **Stafi jo i mjaftueshëm në sektorin e financave dhe tatimin në pronë.**

Afrim Limani


Drejtör për Buxhet dhe Financa